



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

MIRATOHET “PAKETA MONEYVAL”

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR NË FUSHËN E TAKSAVE

TRAJNIMI I ADMINISTRATËS TATIMORE E DOGANORE

MBËSHTETJA DHE NXITJA E ZHVILLIMIT URBAN


PROGRAMI I NXITJES SË PUNËSIMIT

PROJEKTI I FISKALIZIMIT NË SAMITIN BALLKANIK

PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS

DITARI JAVOR

17-22 Qershor 2019



Miratohen 5 projektligjet e propozuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, “Paketa Moneyval”, të cilat synojnë të përbushin rekomandimet që i janë dhënë Shqipërisë nga Moneyval, Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Pastrimin e Parave dhe Luftës kundër Financimit të Terrorizmit. Rekomandimet lidhen me parandalimin e pastrimit të parave, që burojnë kryesisht nga aktiviteti kriminal, dhe forcimi i luftës kundër financimit të terrorizmit, që për qytetarët përkthehet në siguri më të shtuar dhe rrezik më të ulët nga terrorizmi; reduktim të informalitetit në ekonomi; reduktim të përdorimit të parasë fizike; siguri të shtuar financiare dhe bankare; reduktim të ndikimit të praktikave të pastrimit të parave dhe për pasojë reduktim të efekteve negative në jetën ekonomike dhe sociale të çdo qytetari.



Shqipëria do të aplikojë të njëjtat procedura të unifikuar për shmangien e detyrimeve tatimore si ato të vendeve të OECD. Kjo parashikohet në marrëveshjen ndërmjet Shqipërisë dhe OECD, për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS). Gjatë fjalës në Parlament, Ministria Denaj tha se kjo marrëveshje jep mundësinë për të punuar në mënyrë të unifikuar në trajtimin e shmangies tatimore, për të përmirësuar koherencën e rregullave të marrëveshjeve tatimore dhe për të siguruar një ambient tatimor sa më transparent. Pjesëmarrja në këtë Projekt është plotësim i një kriteri thelbësor që e bën Shqipërinë të kualifikohet nga Komisioni Europian në fushat e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet e taksave.



Rritja e profesionalizimit dhe performancës dhe zhvillimi profesional e akademik i administratës tatimore dhe doganore është objektivi i trajnimeve që do të zhvillohen deri në fund të vitit nga Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore e Doganore. Në 6 vite, Qendra ka organizuar 402 seminare, ka mbajtur 618 leksione me një total prej rreth 3000 orësh (4 ore leksioni afërsisht), ndërkohë që synimi i MFE është në një kohë të shkurtër të bëhet një ristrukturim tërësor i funksionimit të saj. E pranishme në nisjen e trajnimeve, Ministria Denaj theksoi se beteja kundër informalitetit, korrupsionit dhe krimit ekonomik nuk mund të fitohet vetëm me paketa ligjore, gjoba e ndëshkime, por kryesore është sjellja profesionale e punonjësve të administratës tatimore e doganore në raport me biznesin dhe tatimpaguesit.



Parlamenti miratoi në seancën e fundit plenare disa ndryshime ligjore që shërbejnë për lehtësimin e investimeve private të huaja dhe vendase, si dhe në funksion të mbështetjes dhe nxitjes së zhvillimit urban. Ndryshimet do të ndihmojnë në zgjidhjen e disa problematikave që ndeshen aktualisht, me disa sipërfaqe toke shtetërore, të cilat preken nga planet e përgjithshme vendore, por që janë në gjendje stoku pa mundësi shfrytëzimi, pasi kuadri ligjor në fuqi nuk e ka të parashikuar rregullimin e kësaj gjendje. Pikërisht për këtë arsye, në funksion të nxitjes dhe mbështetjes së zhvillimit urban sa më të qëndrueshëm dhe dinamik, me qëllim shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve toke/trualli në pronësi të shtetit, u ndërhy në ligjin në fuqi që rregullon këto marrëdhënie.



Shërbimi Kombëtar i Punësimit ha hapur fazën e aplikimeve për Programin e nxitjes së punësimit, bazuar në VKM nr.873, “Për praktikat profesionale të studenteve të sapo diplomuar”. Çdo i ri, i diplomuar brenda 24 muajve të fundit në nivelin Bachelor apo Master dhe që është në kërkim të një eksperience pune mund të aplikojë për programin e praktikave profesionale. Programi subvencionon për çdo pjesëmarrës 13.000 lekë/muaj (50 % të pagës minimale) dhe kontributin për sigurimin nga aksidentet në punë. Çdo kush që dëshiron të bëhet pjesë e këtij programi duhet të paraqitet pranë Zyrës së Punësimit në rajonin ku ka vendbanimin.



3251 persona kanë mundur të punësohen nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrave të punës në të gjithë vendin gjatë muajit Maj 2019. Ndërkohë, cikli i Panireve Rajonale të Punësimit vijoi me Panairin në Berat. 35 kompani nga Berati, Kuçova dhe Skrapari prezantuan në panair 218 vende të lira pune, në sektorë si: hoteleri-turizëm, industri përpunuese, ndërtim, shërbime transporti, tregtare, apo telekomunikacioni. Pjesëmarrës në ishin dhe ofrues të arsimit dhe formimit profesional që ushtrorjnë aktivitetin në Rajonin e Beratit, përfaqësues të institucioneve vendore, si dhe përfaqësues të projekteve bashkëpunuese në fushën e Arsimit, Formimit Profesional dhe Punësimit.



917 persona janë punësuar përmes zyrave të Punës në gjithë vendin gjatë periudhës 14 - 20 qershor 2019. Numrin më të madh të të punësuarve e ka qarku i Tiranës, me 211 persona, ndjekur nga qarku i Durrësit me 167 persona, qarku i Fierit 118 persona, qarku i Shkodrës 81 persona, qarku i Korçës 65 persona, qarku i Lezhës 64 persona, qarku i Elbasanit 56 persona, etj.